

SHABAN SINANI

**DISA MENDIME ORIGJINALE TË DRITËRO AGOLLIT
NË NJË TEZË DIPLOME PËR MIGJENIN**

Punimi i diplomës i Dritëro Agollit është e para monografi kushtuar Migjenit në studimet shqiptare. Titulli i punimit është *Skicat dhe tregimet e shkrimtarit revolucionar shqiptar Migjeni* dhe është paraqitur për mbrojtje në rusisht në vitin 1957, në Petersburg.

Në këtë trajtesë shprehja *mendime origjinale* ka kuptimin e një mendimi që ndryshon prej atyre të studiuesve të tjerë të letërsisë shqipe deri në fund të vitit 1960 e në disa raste edhe më pas. Kemi konsideruar kështu edhe disa *pikëpamje të diskutueshme* të autorit.

1. Duke vlerësuar në mënyrë prapavajtëse grupimet letrare në Shqipëri në vitet 1930 Dritëro Agolli nuk gjen lidhje midis *brezit letrar* të atyre viteve dhe krijimtarisë së Migjenit. Në anën tjetër, ai i sheh Migjenin dhe Mitrush Kutelin *në opozicion të njëri-tjetrit*. Edhe në kohët më kritike për Kutelin, ai është krahasuar me Fan Nolin për qëndrimin e tij kritik të pamëshirshëm *ndaj bejlorçinës*. Por për Dritëro Agollin, Mitrush Kuteli, ashtu si dhe Ali Asllani dhe Kristo Floqi, janë *idealizues të jetës*. Ata e paraqisnin fshatin si *një kënd të qetë, ku dëgjohet zhaurima e përrenjve dhe bilbilat ia marrin këngës së tyre*⁴. Cilësimi i këtyre shkrimtarëve si *të përkundërt me Migjenin* dhe si përngjashëm me ata të *romantizmit prapavajtës (reaksonar)* evropian të modelit François-René Chateaubriand nuk gjendet askund tjetër në studimet historiografike shqiptare. Tregimin *Shitësja e luleve* të Kristo Floqit, ku vajza e varfër është më me fat se karakteret e Migjenit, lypësit apo malësorja e tregimit *A don qymyr zotni*, për shembull, sepse *të pasurit fisnikë dhe zotërinjtë e mirë* e ndihmojnë atë⁵, e sheh si modelin e letërsisë romantike-sentimentale, që i ishte bërë pengesë letërsisë realiste.

2. Qëndrimi ndaj Mitrush Kutelit ndërlikohet duke vërejtur se autori e njuh dhe e ka për mbështetje gjithë traditën e deriatëhershme të studimeve për Migjenin, por nuk mund të mos bëjë përshtypje *harrimi* i artikullit të tij *Të dalim ta presim Migjenin*, shkruar për botimin e *Vargjeve të lira* të vitit 1944⁶.

⁴ D. Agolli, *Skicat dhe tregimet e shkrimtarit revolucionar shqiptar Migjeni*, punim diplome, mbrojtur në gjuhën ruse në Universitetin e Petersburgut më 1957, cituar në dorëshkrimin origjinal me pëlqimin dashamirës të autorit, fl. 48.

⁵ D. Agolli, *vep. cit.*, fl. 41.

⁶ M. Kuteli, *Të dalim ta presim Migjenin*, në *Revista letrare*, 15 mars 1944. Kuteli ishte nga të paktët që e dinte më parë se të dilte libri rikthimin e *Vargjeve të lira*. Në

Mund të supozohej se shkrimi i Mitrush Kutelit dhe përkujdesja e tij për rishtypjen e *Vargjeve të lira*, ndoshta nuk njiheshin prej autorit⁷. Mirëpo, del se, duke mos e gjetur dot poezinë *Trajtat e Mbinjeriut* tek botimi i Gjovalin Lukës dhe në pamundësi për të këshilluar ndonjë kopje të botimit të ndaluar të vitit 1936, Dritëro Agolli është vënë në kërkim të ndonjë burimi tjetër dhe e ka gjetur pikërisht në botimin që Mitrush Kuteli e kishte përsëndetur dy muaj para daljes nga shtypi, të cilin e citon si burim në punimin e tij⁸. Sipas autorëve të vëllimit të tretë të *Historisë së letërsisë shqipe*, mbetur në dorëshkrim (1968), atë ribotim e përgatiti një e motra e tij⁹, por ka argument për ta menduar Mitrush Kutelin si përkujdesës të botimit.

3. Duke polemizuar me pikëpamjen e Dhimitër S. Shuteriqit dhe Vehbi Balës, sipas të cilëve *gogolët e krijuem nga errsina* në skicën e njohur *Gogoli të Migjenit*, përkthyer rasisht me titullin *Në shtëpi, janë hijet e zeza të fashizmit*, që ishte paraqitur si një rrezik evident pas shpërthimit të luftës së

artikullin e përmendur ai shkruante: *Një lajm i mirë për lëçitësin shqiptar: Komisioni për shqyrtimin e librave, që vepëron pranë Ministrisë së Kulturës Popullore, dha pëlqimin e vet për qarkullimin e "Vargjeve të lira" të Migjenit. Me sa duket, Kuteli nuk qe vetëm nun i këtij botimi. Të dhëna të tërthorta na shpjen në bindjen se ai u kujdes vetë për këtë.*

⁷ Konsiderojmë se, në mos përkujdesës i drejtpërdrejtë, Kuteli ishte së paku *solecitus* e *nun* i botimit jo vetëm prej faktit që ai u bë përruesi i parë i botimit të vitit 1944. Ky botim, me të njëjtin titull si në atë të vitit 1936 dhe pothuajse me të njëjtën paraqitje teknike, nëse i besojmë anës së pasme të ballinës së librit, doli në muajin prill, kurse Mitrush Kuteli e paraqiti në muajin mars. Sa i takon shenjimit *T'ardhurat e këtij shkojnë në dobi të familjes s'Autorit*, që gjendet po aty, gjen shpjegim me detyrimin që kishte shtypshkronja *Gutenberg* dhe pronari i saj Mal'Osmani prej botimit të parapaguar të vitit 1936. Nëse për botimin e vitit 1944 do të kishte pasur ndonjë kujdes familjar, Skënder Luarasi, ribotues i *Vargjeve të lira* më 1957 dhe më 1962 do ta kishte përmendur doemos. Zor që të besohet se Ismail Mal'Osmani i pati dhënë kompetencë vetes të prekte përmbajtjen e librit siç ishte shtypur në vitin 1936. Heqja e dy vjershave, si dhe përfshirja e Ministrisë së Kulturës Popullore si lejuese e botimit, na çon tek autoriteti i një shkrimtari si Kuteli, i cili e kishte bërë të njëjtën gjë me Lasgush Poradecin (janë të njohura letrat e tij *urdhëruese* që miku i tij i vendlindjes dhe i mërgimit të dorëzonte sa më shpejt vëllimin për botim) dhe me Fan Nolin (vëllimi *Mall e brengë - Me një vështrim kritik prej Mitrush Kuteli-t*, botuar më 1943, i përgatitur prej tij, u bë shkas që Noli vite më vonë të mblidhte në *Albumin* e njohur vjershat dhe përkthimet më të mira).

⁸ D. Agolli, vep. cit., fl. 89. Ja citimi i plotë prej tij: Migjeni, *Svobondnie stihi*, izd. 1944, f. 36.

⁹ K. Bihiku (kryered.), *Historia e letërsisë shqipe*, vëllimi III, përgatitur për shtyp nga Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, ruhet në dorëshkrim.

Spanjë¹⁰; po ashtu dhe me pikëpamjen e Gjovalin Lukës, që ishte shprehur se *gogoli është imperializmi*¹¹, Dritëro Agolli formulon një prej përfundimeve më origjinale në rrafshin e interpretimit të tekstit. Me sa duket edhe nën ndikimin e fjalisë së parë të *Manifestit të Partisë Komuniste: një fantazmë po i afrohet Europës, komunizmi*, autori pohon se *gogoli në këtë skicë është Bashkimi Sovjetik*. Arsyetimi gjithsesi nuk ka referencë të drejtpërdrejtë të *Manifesti*. Nëse *gogoli* është kapitalizmi apo imperializmi, atëherë *njerzit e vegjël në errësinë* duhet të jenë popujt, dhe prej këndej duhet pranuar se *Migjeni tallet me popujt*. *Ky shpjegim nuk është logjik e bindës*, argumenton Dritëro Agolli.

4. Duke u shprehur kundër interpretimit të Vehbi Balës për skicën *Vdekjen e trumcakut*, sipas të cilit përmes saj Migjeni don të tregojë se *ndihet i huaj në mes njerëzish të pasinqertë* dhe se vendi i tij, Shqipëria, *është një tokë pa fryt*¹²; po aq dhe kundër mendimit të Gjovalin Lukës për këtë skicë, në të cilën ai gjen shprehjen e një *pesimizmi skajor* të Migjenit, deri në *mohimin e vetvetes*¹³ (shpjegim që autori i punimit e cilëson *jashtë logjike*), Dritëro Agolli paraqet një prej shpjegimeve më origjinale për trumcakun si simbol. Sipas tij, melankolia e trumcakut nuk është gjë tjetër përveçse kompleksi megaloman i intelektualëve të përciptë, të cilët ankohen se s'mund të lulëzojnë jo se s'kanë dhunti, përkundrazi, ata janë lindur për të qenë gjenij, por sepse Shqipëria, me vogëlsinë e saj, nuk mund të krijojë hapësirë gjenish¹⁴. Migjeni në këtë skicë *nuk mohon vetveten*, siç qenë shprehur botuesit dhe studiuesit e tij. Në skicën *Vdekja e trumcakut* nuk është fjala për ndonjë *filozofi të pafrytshme*. Migjeni nuk ka kurrfarë qëllimi që të vërtetojë se në *Shqipëri edhe trumcaku nuk ka rrugë tjetër veç vetëvrasjes*¹⁵, por thjesht të ironizojë *gjenijtë e rremë*, që i gjen ndër ata të paktë intelektualë, që ishin arsimuar në Perëndim dhe gjenin si shprehje proteste pseudo-zhëngjimin.

5. Në tri skica të Migjenit Dritëro Agolli sheh një vetëdije të pashpallur antifashiste. Skicat *Ose ... ose* dhe *Të korrurat* sipas tij janë të drejtuara kundër luftës. Sipas autorit, ashtu sikurse *Bota e Re* ishte shprehur kundër

¹⁰ Krhs. Gjovalin Luka (mbledhë e redaktue), në Migjeni, *Vepra*, Tiranë, 1954, f. 121: *Asht fjala për manifestimet e shumta që organizojshin fashistat italianë e gjermanë; ka aluzion për shtypin përparimtar, që demaskonte imperializmin*. Dhe D. Agolli, vep. cit., fl. 68: *Migjeni pasqyron manifestimet e tërbuara të "njerëzve të vegjël të zinj", fashistëve, që po mobilizonin si ushtarë popujt e tyre, në këmbët e titanit - Bashkimit Sovjetik*.

¹¹ D. Agolli, vep. cit., fl. 68-69.

¹² D. Agolli, vep. cit., fl. 74.

¹³ D. Agolli, vep. cit., fl. 74-75.

¹⁴ D. Agolli, vep. cit., fl. 73.

¹⁵ D. Agolli, vep. cit., fl. 75.

luftërave të padrejta, duke parandier luftën botërore, Migjeni nuk e harron as këtë temë dhe shkruan skicën *Urime për 1937*, të drejtuar kundër agresionit fashist në Spanjë¹⁶. Ndonëse në këtë interpretim mund të ketë diçka të tepruar, një mbitheksim ideologjik të antifashizmit të Migjenit, Dritëro Agolli nuk gabon aspak kur, duke hyrë brenda tekstit të skicës *Të korrurat*, arrin në përfundimin se ajo pasqyron militarizimin fashist, duke e vështruar sintagmën e Migjenit *topa në vend të bukës* si një perifrazë të parullës fashiste: *topa në vend të gjalpit*.

6. Në studimet për Migjenin skica *Historia e njenës nga ato* është krahasuar me poezinë *La prostitution sacre* të Ch. Baudelaire-it dhe ndonjëherë edhe me *La Putain respectueuse* të Jean-Paul Sartre-it, megjithëse kjo vepër u botua pas Luftës II Botërore. Supozimi i Dritëro Agollit, se *Historia e njenës nga ato* është e ndikuar prej Guy de Maupassant-it¹⁷ (ndoshta kishte në mendje novelën e tij *Boule de suif*) dhe jo prej *Le prostitution sacre* të Baudelaire-it, është gjithashtu pjesë e origjinalitetit të punimit të tij. Dritëro Agolli është i pari që e quan Lukjen heroinë të tregimit dhe jo personazh: *Lukja është prostitutë, por morali i saj është më i lartë se i atyre që e çuan drejt vdekjes: Lukja është një grua e ndershme*¹⁸, pohon autori. Dhe kjo të sjell ndërmend shëmbëlltyrën e Krishtit me Mari-Magdalenën.

7. Shumë është diskutuar për ndikimin niçean në poezinë e Migjenit. Dritëro Agolli nuk pajtohet me mendimin e Dhimitër S. Shuteriqit shprehur në kreu për Migjenin në *Historinë e letërsisë shqipe* (për shkollat e mesme) hartuar prej tij dhe botuar në vitin 1955, si dhe në ndonjë shkrim tjetër i tij¹⁹, ku, siç ai shprehet, *në mënyrë të gabuar* ndikimi i Niçes dhe ai i Dostojevskit vihen në një kahje, ndërkohë që *idetë e Niçes e ulin cilësinë e kësaj vepre, kurse ato të Dostojevskit e lartësojnë*²⁰. Por Dritëro Agolli është i pari që bëri krahasimin në rrafshin tekstologjik midis poezisë *Trajtat e Mbinjeriut* dhe një fragmenti të librit të F. Nietzsche-s *Ashtu foli Zarathustra*. Për më tepër, ai nuk e sheh ndikimin niçean prej *Le gai savoir*, prej esesë së njohur të filozofit klasik gjerman, në të cilën shtrohet pyetja *Ku është zhdukur Zoti klasik*, që na sillet në mendje prej poezisë së Migjenit *Perëndi, ku je?* Dritëro Agolli arrin në përfundimin se Friedrich Nietzsche padyshim ndikoi në idetë e Migjenit, por *agresiviteti, shovinizmi dhe amoraliteti i mendimtarit reaksionar gjerman janë krejt të huaja për të, qoftë si njeri, qoftë si*

¹⁶ D. Agolli, *vep. cit.*, fl. 19.

¹⁷ D. Agolli, *vep. cit.*, fl. 36.

¹⁸ D. Agolli, *vep. cit.*, fl. 39.

¹⁹ Njëri prej tyre dhe më i cituari nga autori që botuar në revistën *Literatura jonë*, nr. 8, viti 1948, f. 8 e vijim.

²⁰ D. Agolli, *po aty*, fl. 6-7.

*shkrimtar*²¹. Përmes të njëjtit krahasim, ai zbulon tek *ditirambi niçean* i Migjenit *shkallën më të lartë të ndikimit të mendimit të Nietzsche-s* në konceptin e tij për *Mbinjeriun*, shfaqur në formën e gjeniut, që tek poeti shqiptar *përkthehet* në formën e fatalizmit dhe të përfytyrimit të gabuar të raporteve midis individit dhe popullit²².

8. Një prej përcaktimeve më të diskutueshme të Dritëro Agollit për Migjenin është cilësimi si *poet kombëtar*. Edhe sikur këtë cilësim ta marrim si të ardhur prej kuptimit të dyfishtë të fjalës gjegjëse në rusisht: *narodnoje*, të cilin Albert Lord e quan një *fjalë djallëzore*, sepse ka njëherësh edhe kuptimin *kombëtare*, edhe kuptimin *popullore*, nuk është e lehtë të pranohet si bindës. Dritëro Agolli, për të argumentuar këtë përcaktim, në krye bën dallimin kuptimor në shqip midis mbiemrit *kombëtar-e* dhe mbiemrit *nacionalist-e*. Autori mendon se vetëquajtja *nacionalistë* për një grupim veprimtarësh politikë të kohës, *që kishin në duar shtypin zyrtar*, është thjesht një eufemizëm, përtej të cilit duhen parë idetë fashiste dhe naziste. Të tillë, *nacionalistë, e mbanin veten Branko Merxhani, redaktor i revistës reaksionare "Përpjekja shqiptare" dhe fashisti Ismet Toto, me gazetën e tij "Arbëria". Bashkë me ta, shkrimtarët Ernest Koliqi e Vangjel Koça me kompani, në revistën "Iliria", himnizonin "diktaturën e ndritur fashiste" që ishte vendosur në Itali dhe Gjermani*²³. A është krijimtaria e Migjenit me karakter kombëtar? Duke i deestetizuar kategoritë themelore të romantizmit dhe duke i dhënë së shëmtuarës vlerën e së bukurës (një përmbysje që nuk kishte ndodhur kurrë më parë në letërsinë shqipe); duke e rrotulluar letërsinë prej madhësisë së historisë së maleve dhe malësorëve në jetën brutale të qytetit; duke iu larguar heronjve të mbifuqishëm për t'u afruar me njerëzit në anësitë e jetës, Migjeni iu largua edhe temës kombëtare, me të gjitha mitet e veta: lavdia historike, virtytet përjashtimore, krenaria e origjinës, lashtësia primitive e riteve dhe rendit shoqëror²⁴, duke shkuar deri tek cilësimi i *Melodis kombtare* si *Kanga që s'kuptohet*.

9. Me shumë maturi Dritëro Agolli, ndryshe prej disa studiuesve të mëvonshëm, të cilët nuk kanë munguar të krahasojnë me zell notat në dëftesat shkollore të seminaristit në teologji, dogmë e doktrinë dhe gjuhë serbe, me notat në lëndët laike, për të arritur shpejt e shpejt në përfundimin se shërbesa dhe meshtaria ishin të huaja për të, shkruan se *ne nuk e dimë nëse Migjeni*

²¹ D. Agolli, *vep. cit.*, fl. 7.

²² D. Agolli, *vep. cit.*, fl. 89-90.

²³ D. Agolli, *vep. cit.*, fl. 13.

²⁴ Po përmendim disa prej nëntitujve të punimit të Dritëro Agollit për të kuptuar se edhe vetë autori, përmes tyre, as për së largu nuk jep shenja për praninë e idesë dhe miteve kombëtare në veprën e Migjenit: *Fati i malësorit të ri në qytet, Të varfrit e rrugicave qytetare, Malësorja në skicat e Migjenit*. Shih D. Agolli, *vep. cit.*, fl. 2.

*donte të vazhdonte të shkollohej për prift apo jo*²⁵, duke u pajtuar me Vehbi Balën, sipas të cilit ai nuk hoqi dorë nga qëllimi për t'u shkolluar dhe më tej në *Ungjill e Shkrime*, ndonëse nuk kishte ndonjë dëshirë të madhe. Ndoshta vërtet Migjeni dëshironte të ndiqte universitetin në një prej shkencave humanitare (V. Bala dhe D. Agolli), që nënkupton se teologjia nuk konsiderohej e tillë, por mendimi se poeti kishte *urrejtje për besimin*²⁶, sido që një ide e mbrojtur nga një shumicë studiuesish të mëvonshëm, mbetet ende krejt i diskutueshëm.

10. Originaliteti i punimit të Dritëro Agollit shpërfaqet veçmas në qëndrimet kritike ndaj studimeve të mëparshme. Megjithëse një libër i ndaluar, Dritëro Agolli e përmend ekzistencën e botimit të Gjovalin Lukës (1954), dhe hera-herës polemizon e kundërshton interpretimet e përgatitësit dhe përkujdesësit të tij, siç është rasti i pohimit se në skicën *Legjenda e misrit Migjeni përdor fjalën “përrallë” për të treguar se misri është bërë përralla e ditës (!?) dhe se kudo e nga të gjithë vetëm për misrin flitet*²⁷. Kjo pikëpamje nuk është e drejtë sepse nuk pajtohet me bindjet e Migjenit, shkruan Dritëro Agolli, dhe kjo është arsyeja që mbahet qëndrim brenda tekstit edhe me shenjat e pikësimit. Shkrimtari e quan skicën e tij “*legjendë*” jo pse misri ishte bërë “*përrallë dite*”, por sepse misri përfaqëson diçka hyjnore; në këtë fjalë fshihet një kuptim magjik: për misrin thuren legjenda njësoj si këngët dhe odet që u kushtoheshin në lashtësi perëndive të Olimpët²⁸.

11. Dritëro Agolli nuk është indiferent ndaj gjendjes dhe rendit gjuhësor në veprën e Migjenit. Ai vëren me të drejtë se *Migjeni ishte lindur në Veri dhe prandaj shkroi në dialektin e gegërishtes, por megjithatë ai ka një tërheqje të dukshme ndaj dialektit tosk, që ishte më afër gjuhës së letërsisë, prandaj në veprën e tij ka kalime të lehta nga njëri dialekt në tjetrin*²⁹.

12. Gjatë gjithë punimit, por në mënyrë të veçantë në mënyrën si analizon novelën *Studenti në shtëpi*, Dritëro Agolli gjen në veprën e Migjenit, edhe me sforcim, një raport antagonizmi midis Perëndimit dhe Bashkimit Sovjetik. Diku ky raport paraqitet i lidhur me Shqipërinë: në periudhën midis dy luftërave fuqitë e Perëndimit vazhduan të ishin një rrezik për pavarësinë e vendit. Në raste të tjera Perëndimi satanizohet për shkak të rrezikut fashist e nazist si rrezik botëror. Diku tjetër për antisovjetizmin e tij. Ne këtu po i

²⁵ D. Agolli, *vep. cit.*, fl. 23.

²⁶ D. Agolli, *vep. cit.*, fl. 23.

²⁷ D. Agolli, *po aty*, fl. 51. Krhs. Migjeni, *Vargjet e lira*, mbledhë e shpjegue nga Gjovalin Luka, Tiranë, 1954, f. 115: *Si në titull, ashtu edhe gjatë kësaj pjese të fuqishme, Migjeni do ta përdorë shpesh fjalën “legjendë”, tue lanë me kuptue me të se misri ishte bamë si prallë e ditës, që kudo bisedohej.*

²⁸ D. Agolli, *po aty*, fl. 51.

²⁹ D. Agolli, *vep. cit.*, fl. 102.

përmbahemi vetëm novelës *Studenti në shtëpi*, meqë mundësitë për përdorim politik janë më të kufizuara. Nushi, njeriu midis joshjes për të dalë jashtë kodit, jashtë kanunit, nën ndikimin e ideve të qytetërimit të Perëndimit, a i bindet pikëpamjes së Dritëro Agollit, për karakterin dekadent të shoqërisë dhe sistemit politik që ka ndërtuar? Duket se autori ka dëshirë që dhe këtë skicë ta propozojë për një lexim anti-Perëndim, por më në fund konkludon: *Nushi është një figurë, shembull tipik i shoqërisë borgjeze, e intelektualit liberal që lufton për një protestë të hapur ndaj realitetit*³⁰. Mendimi i Dritëro Agollit për kritikizmin antiperëndimor të Migjenit mbetet pak i mjegullt: A ishte kritik ndaj rezikut nazifashist, që vinte nga Perëndimi, apo edhe ndaj qytetërimit perëndimor? *Miti i Perëndimit*, që ishte shpallur krenarisht gjatë periudhës së romantizmit, përmes poezive të Naim Frashërit dhe të Jeronim de Radës, do të ishte mbisundues edhe tek Migjeni, pavarësisht dukurive që qortoheshin prej tij, të paraqitura drejt në punimin e Dritëro Agollit. Kjo çështje, në kohën kur u hartua punimi, nuk kishte dalë ende, por afro dy dekada më vonë do të parashtrohej dhe do të merrte një zgjidhje të denjë në studimet e Arshi Pipës³¹.

BIBLIOGRAFI

- Agolli, D., *Очерки и рассказы революционного албанского писателя Мудьени – Skicat dhe tregimet e shkrimtarit revolucionar shqiptar Migjeni*, punim diplome, mbrojtur në gjuhën ruse në Universitetin e Petersburgut më 1957.
- Agolli, D., *Skicat dhe tregimet e shkrimtarit revolucionar shqiptar Migjeni*, përg. për botim Shaban Sinani, preprint i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, Tiranë, 2016.
- Bihiku, K. (kryered.), *Historia e letërsisë shqipe*, vëllimi III, përgatitur për shtyp nga Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, ruhet në dorëshkrim.
- Kuteli, M., *Të dalim ta presim Migjenin*, në *Revista letrare*, 15 mars 1944.
- Luka, Gj. (mbledhë e shpjegue), Migjeni, *Vepra*, Tiranë, 1954.
- Pipa, A., *Mythe de l'Occident dans la poésie de Migjeni*, në *Südost-Forschungen*, Bild XXX, München, 1971.
- Sinani, Sh., “Njerëzit e krisur” të Dritëro Agollit”, bot. Naimi, Tiranë, 2012.
- Sinani, Sh., *Ikje prej mitit të malit*, në revistën *Malësia*, nr. 8, Podgoricë, 2013.

³⁰ D. Agolli, *vep. cit.*, fl. 82.

³¹ A. Pipa, *Mythe de l'Occident dans la poésie de Migjeni*, në *Südost-Forschungen*, Bild XXX, München, 1971, f. 142-175.

Sinani, Sh., Migjeni i Dritëro Agollit, në *Skicat dhe tregimet e shkrimtarit revolucionar shqiptar Migjeni*, preprint i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, Tiranë, 2016.

SUMMARY

SOME ORIGINAL VIEWS OF DRITERO AGOLLI IN HIS DIPLOMA THESIS ON MIGJENI

The sketches and the stories of the Albanian revolutionary writer Migjeni by D. Agolli is the first monograph devoted to Migjeni, written as a diploma thesis in Russian in 1957. While evaluating the literary groups in Albania in the 1930s, the author sees Migjeni and Mitrush Kuteli *in opposition to each-other*. For him, even Ali Asllani and Kristo Floqi are *idealizers of life*, as they present the village as a *quiet corner, where you can hear the flow of the streams and where the robins start their song*.

Debating on the view that *the phantoms created from the darkness* in Migjeni's famous sketch "*The Phantom*", are the black shadows of fascism, or that *the phantom refers to the imperialism*, apparently under the influence of the *Communist Party Manifesto*, he claims that the phantom in this sketch is the Soviet Union and communism.

D. Agolli disagrees with some interpretations of the sketch of the *Suicide of the Sparrow*, according to which Migjeni wants to show that *he feels alien among the insincere people* and that his country *is a fruitless land*; or that this sketch reveals the expression of Migjeni's far-edge pessimism *to the point of self-denial*. According to the author, the melancholy over the finch is nothing but the megalomaniac complex of superficial scholars who complain that they can not flourish as geniuses because Albania, with its small size, can not provide space for such. In this sketch, Migjeni simply want to ironize *fake geniuses*.

D. Agolli maintains that the sketches *Or ... or* and *The Harvest*, are targeted against the war. Migjeni does not neglect this subject even when writing the sketch *Wishes for 1937*, directed against the fascist aggression in Spain. Though there may be an ideological over-evaluation of Migjeni's anti-fascism in this interpretation, D. Agolli is not mistaken, at the beginning of the sketch *The Harvest*, while he concludes that it reflects on the fascist militarization, and he regards Migjeni's phrase *canons instead of bread* as the periphrasing of the fascist slogan: *canons instead of butter*.

In the research into Migjeni's sketches, *The story of One of Them* is compared to Ch. Baudelaire's *La prostitution sacrée* and even to Jean-Paul

Sartre's *La putain respectueuse*. D. Agolli asserts that *The story of One of Them* is influenced by Guy de Maupassant (comparing with *Boule de suif* nouvelle), and it is also part of the author's originality of the work.

D. Agolli disagrees with the view that Nietzsche and Dostoyevsky have equally influenced Migjeni, because *Nietzsche's ideas reduce the quality of his work, while those of Dostoyevsky exalt him*. D. Agolli is the first to draw a comparison at the discourse level between *The Shapes of the Superman* and a fragment of F. Nietzsche's *Thus spoke Zarathustra*. In the novel *The student is back home*, D. Agolli thinks that the West is satanized because of fascist and Nazi threat as a world threat, and elsewhere for its anti-Sovietism. His opinion on Migjeni's anti-Western criticism remains a bit blurry: Was he critical of the Nazi-fascist threat that came from the West or even to Western civilization? *The Myth of the West* would be dominant in Migjeni, despite the phenomena that were criticized by him.

